



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, mbajtur më 28.10.2022, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fiknete Bejta-LDK, kryesuese, Arbër Vokrri-VV, Taulant Maxharraj-AAK, Mimoza Xhaka- Bllacaku-eksperte e jashtme.

Në mbledhje ishte prezent edhe Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë.

**Mungoi: Liridon Selmani-PDK.**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fiknete Bejta, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

### REND TË DITËS:

1. Informatë rreth raporteve të punës së Drejtorisë së Mirëqenies Sociale;
2. Informatë për aktivitetet në kuadër të organizimit "Tetori rozë";
3. Të ndryshme.

Kryesuesja, konstatoi se njëzëri u miratua rendi i ditës.

Kryesuesja tha se për këtë mbledhje ka qenë e ftuar drejtorja e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale për të na raportuar rreth punëve të drejtorisë, por në mungesë të saj, kjo pikë mbetet për diskutim në mbledhjet e radhës.

#### Pika e dytë

#### Informatë për aktivitetet në kuadër të organizimit "Tetori rozë"

Lidhur me Informatën për aktivitetet në kuadër të organizimit "Tetori rozë", të pranishmit i informoi Izet Sadiku, drejtor i cili tha se si drejtor i Komunës kemi qenë pjesë e aktiviteteve si dhe kemi bërë një lloj koordinimi me OJQ-të dhe partnerët e tjerë dhe kemi mbajtur një numër të madh të ligjëratave nëpër shkolla, me pjesëtar të FSK-së, me pjesëtarë të Policisë së Kosovës, në xhamia.

Si aktivitet i veçantë këtë vit ka qenë "Prishtina e rrugës", e që ne kemi bërë përgatitje duke filluar nga nesër pra, më 29 tetor, një pjesë e madhe e objekteve komunale do të kenë ndriçim rozë, po ashtu një pjesë e xhamive me qenë rozë, një pjesë e katedrales, e Pallatit të Rinisë, e Termokosit, pra objekte që do të ngjyrosen rozë.

Gjithashtu kryetari i Komunës ka marrë një vendim që të gjitha gratë që bëjnë kontrollet për mamografi ato të bëhen falas, si dhe nga muaji janar i viti 2023, ne do t'i subvencionojmë ato gra të cilat kanë nevojë për proteza të gjirit. Manifestimet dhe debatet të cilat janë mbajtur në këtë muaj e kanë rritur numrin e kërkesës për mamografi.

Gjithashtu nga 1 nëntori do të bëhen vizitat sistematike të nxënësve nëpër shkolla dhe po ashtu është menduar që në të ardhmen gradualisht që përveç punëve që ka mjeku familjar, të përgatiten për të qenë më të kompletuar, me ditë me interpretuar me EKG-në, me ultrazë, etj.

**Kryesuesja**, tha se ne kishim mundur ta kemi një aktivitet edhe për muajin e solidaritetit që është muaji nëntor dhe për këtë do të ishte mirë që të bashkëpunojmë edhe me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, pra ta kemi një aktivitet simbolik diçka që mund të tregojmë se ja vlen të flasim për këtë temë, se problemet sociale janë të mëdha dhe të ndjeshme.

**Arbër Vokri**, tha se nëse kishim mundur t'i identifikoni disa familje që i kanë kushtet shumë të rënda sociale, ku njëra nga ato është edhe familja e Metush Krasniqit, në lagjen "Arbëria" dhe unë personalisht e kam vizituar atë familje e cila jetojnë në kushte shumë të rënda. Aty për veç tjerash kundërmon erë e rëndë nga kanalizimi, kështu që do të ishte më se e nevojshme që ajo familje të përfshihet në listën në rast të shpërndarjes së ndonjë ndihme.

**Kryesuesja**, tha se muaji i ardhshëm është muaji i solidaritetit dhe do të ishte mirë që të kemi një bashkëpunim me kabinetin e kryetarit dhe me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, për t'i shikuar mundësitë se çka mundë të bëjmë kur e dimë se problemet sociale janë shumë të ndjeshme, sidomos në këtë kohën e nëntorit kur vërehen më shumë.

**Mimoza Xhaka**, tha se para se të përcaktohet ndonjë listë me emra për ndihmë, së pari duhet verifikohet ajo familje se a është rast social apo jo, pasi që kemi shumë rast ku po keqpërdoren këto ndihma financiare.

**Kryesuesja**, tha se janë disa familje që janë në gjendje të rëndë sociale dhe pasi që është muaji i solidaritetit, kishim mundur të bëjmë njëfarë aktiviteti dhe të na bashkëngjiten edhe ata persona që kanë shprehur gatishmëri solidare për këto raste, pasi që puna e komitetit është pak simbolike.

Nuk kemi ndonjë kompetencë që mundë të shtyjmë diçka përpara se e pamë edhe tek buxheti edhe pse propozimet që i morëm këtu unë i kam dërguar edhe në Drejtori të Shëndetësisë, por buxheti është vendosur krejt ndryshe, kështu që mundësitë janë shumë të vogla.

**Mbledhja përfundoi në orën 16:45.**

**Procesmbajtësja**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesuesja e komitetit**  
**Fiknete Berja**

Faqe 2 nga 2

